

Logo ASHMDF

LOGO MPCSSHB

RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË LIGJIT “PËR MBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË FËMIJËVE”

Foto

HYRJE

Miratimi i një ligji të ri për të drejtat e fëmijëve, erdhi si një domosdoshmëri për thellimin e reformës legislative dhe institucionale, për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët.

Rritja e ndërgjegjësimit të familjes, shtetit dhe shoqërisë civile, parandalimi dhe eliminimi i fenomeneve që dëmtojnë shëndetin dhe mirëqënien e fëmijëve, përbëjnë objektiv madhor në fushën e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut.

Në këto kushte, duke e konsideruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, një detyrim kushtetues, ligjor dhe moral, por edhe si një çështje e rëndësishme të procesit të integritimit europian të Shqipërisë, u ndërmor iniciativa për hartimin e Ligjit ‘Për të Drejtat e Fëmijës’, i cili përfshin të gjitha të drejtat e fëmijëve si dhe mekanizmat që do të bëjnë të mundur garantimin e tyre.

Ky raport është raporti i parë që vlerëson zbatueshmërinë e këtij ligji, 1 vit pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij.

Raporti paraqet ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe për plotësimin e kuadrit ligjor në zbatim të ligjit dhe dokumentat e rinj politikë që synojnë të përçojnë frymën e bashkëpunimit institucional duke filluar që nga hartimi i politikave të përbashkëta dhe të harmonizuara për realizimin e të drejtave të fëmijëve në tërësi.

Në kapitullin e dytë paraqitet një panoramë e situatës lidhur me ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave institucionale në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

Kapitulli i tretë paraqet situatën aktuale, pra zhvillimet e fundit në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik.

Raporti është përgatitur në bazë të informacioneve të raportuara nga institucionet qendrore përgjegjëse për zbatimin e ligjit, njësitë për fëmijët në nivel qarku/bashki/komunë dhe shoqëria civile.

KAPITULLI I: DOKUMENTA POLITIKË DHE KUADRI LIGJOR I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Gjatë periudhës 2011-2012 është miratuar dokumenti politik i Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015 dhe disa akte ligjore e nënligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e të drejtave të fëmijëve

PLANI I VEPRIMIT PËR FËMIJË 2012-2015

Në mbështetje të politikave të harmonizuara dhe gjithëpërfshirëse për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe në kuadër të përmbushjes së një nga pikave të rekomandimit 11 të BE, është miratuar më 13 mars, Plani i Veprimit për Fëmijët 2012-2015 (VKM Nr 182 datë 13.03.012). Procesi i hartimit të Planit të Veprimit ka qënë një proces gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e institucioneve në nivel qendror e vendor dhe shoqërisë civile. Është bazuar në rekomandimet e raporteve të vlerësimit të Strategjisë së mëparshme për Fëmijë 2005-2010, studime të ndryshme në fushën e të drejtave të fëmijëve, Strategjinë Europiane për Fëmijë 2012-2015, Udhërrëfyesin e Hagës për eliminimin e punës së fëmijëve etj.

Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015 ka për qëllim të nxisë hartimin e politikave gjithëpërfshirëse, të koordinuara e harmonizuara të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve si dhe vë theksin në forcimin e strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar e rajonal.

Objektivat dhe masat e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015 janë grupuar sipas të drejtave të fëmijës:

1. E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale
2. E drejta e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik
3. E drejta për zhvillim dhe arsim
4. E drejta për kujdes shëndetësor
5. E drejta për mbrojtje ligjore

1.E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale

Në përgjigje të nevojave në rritje për shërbime gjithëpërfshirëse cilësore sociale plani i veprimit për fëmijë, nënvizon domosdoshmërinë e një vëmendje të veçantë mbi nevojat e fëmijëve në programin e ndihmës ekonomike, me qëllim parandalimin e fenomenëve sociale negative që rrisin përjashtimin e fëmijëve të varfër, reformimin e sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë si dhe harmonizimin e politikave për të drejtat e fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.

2.E drejta e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi ekonomik

Plani i veprimit për fëmijë paracakton se njësitë e qeverisjes vendore duhet të intensifikojnë përpjekjet për marrjen e përgjegjësisive financiare, ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me dinamikën e nevojave të fëmijëve në komunitetet e tyre, mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe format më të këqija të punës,

3.E drejta për arsim

Në mënyrë të detajuar, realizimi i kësaj të drejte synon një sistem arsimor gjithpërfshirës dhe cilësor për fëmijët si dhe rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin vendimarrës në shkollë dhe jashtë saj.

4. E drejta e mbijetesës dhe e kujdesit shëndetësor

E drejta e mbijetesës dhe e kujdesit shëndetësor do të realizohet nëpërmjet arritjes së rezultateve strategjike si: Sigurimi i kujdesit esencial shëndetësor për çdo foshnjë të porsalindur, parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët, ushqyerja e shëndetshme, vaksinimi.

5.E drejta për mbrojtje ligjore

Vazhdimësia e politikave ekzistuese si edhe hartimi i politikave të reja në fushën e drejtësisë për të mitur synojnë mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e fëmijëve nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin, si dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të krimit.

Lidhur me kuadrin ligjor që garanton të drejtat e fëmijëve, gjatë vitit 2011 janë miratuar aktet e mëposhtme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve.

LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Ligji nr.10425, datë 02.06.2011, për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”. Objekti i kësaj konvente është të mbrojë interesin më të latë të fëmijëve, të promovojë të drejtat e tyre, t’u japë të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime para një autoriteti gjyqësor, për çështje që lidhen me ta.

Ligji nr.10424, date 02.06.2011 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës, “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesë”. Kjo konventë synon përmirësimin e statusit ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesë, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë të cilat janë në disavantazh juridik ose social me të parët;

LEGJISLACIONI KOMBËTAR

Ligj Nr. 23/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në kuadër të ndryshimeve në kod, janë ndryshuar edhe nenet 124/b dhe 128 që kanë të bëjnë me keqtrajtimin dhe trafikimin e fëmijëve.

Ligji ‘Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve’ nr 10347, dt 4.11.2010, përcakton të drejtat e fëmijëve në koherencë me Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijës. Ligji vendos themelin për ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm institucionalë që do të garantojnë dhe sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja, dhe shteti. Ligji siguron të gjitha masat e nevojshme për garantimin e jetës, mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijës nëpërmjet një qasje të koordinuar ndërmjet aktorëve të ndryshme që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

Ligji synon të përmirësojë sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri duke institucionalizuar Njësitë e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës si struktura të nivelit vendor të cilat përgjigjen për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme që veprojnë në nivel vendor. Gjithashtu, në këtë ligj parashikohet si detyrim ligjor bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe shoqërinë civile, duke e rregulluar këtë marrëdhënie nëpërmjet rregullave të miratuara me 5 Vendime të Këshillit të Ministrave të listuar më poshtë.

VKM NR 263, datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Ligji 10347 datë 4.11.2010 përcakton rregullat e bashkëpunimit të mekanizmave institucionale në nivel qendror dhe vendor me organizatat jofitimprurëse për realizimin me efektivitet të politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

VKM përcakton mënyrën e bashkëpunimit duke vënë theksin në fusha konkrete si :Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, strategjive kombëtare dhe rajonale që kanë në fokus të drejtat e fëmijëve; ngritjen dhe fuqizimin e NJMF, NJDF, strukturave të ngarkuara me çështje sociale në nivel komune, bashkie, qarku; në mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik; trajnimet dhe programet e përbashkëta; ofrimin e shërbimeve për fëmijë; analiza, studime, mbledhje e të dhënave statistikore dhe shkëmbimi i informacionit; hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta; mbështetje për hartimin e raporteve kombëtare sipas detyrimeve që rrjedhin nga të gjitha aktet ndërkombëtare.

VKM NR 264, datë 12.04.2012 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”

VKM është mbështetur në nenin 37 pika 4 të Ligjit nr.10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” sipas të cilit shkeljet e të drejtave të fëmijëve, që përbëjnë kundravajtje administrative do të ndëshkohen me gjobë, duke përjashtuar rastet kur kjo shkelje përbën veprë penale apo është subjekt i ndëshkimit nga ligje të tjerë. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) është parashikuar si autoriteti shtetëror përgjegjës për monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve dhe si organi që do të sanksionojë me gjobë shkelësit e ligjit..

VKM NR 265, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”

VKM përcakton mekanizmin për të trajtuar rastet e fëmijëve në rrezik dhe mënyrën se si procedohet për këto raste. Përcaktohen qartë strukturat që janë pjesë e mekanizmit si dhe detyrat konkrete për gjithsecilën prej tyre. Në nivel vendor janë: Komiteti Drejtues në nivel qarku, grupi teknik multidisiplinar, njësia për të drejtat e fëmijës në nivel qarku, njësia për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkie/komune. Vendimi paraqet edhe procedurën për ndërhyrje në ndihmë të fëmijëve në rrezik dhe procedurën për ndërhyrje në rastet kur fëmija konsiderohet në situatë emergjente. Kjo e fundit parashikon që fëmija në situatë emergjente të merret në mbrojtje të menjëhershme nga strukturat e policisë në bashkëpunim me NJMF dhe Shërbimin Social

Shtetëror, edhe jashtë orarit zyrtar të punës si dhe do t'i ofrohet në mënyrë të menjëhershme strehim, ushqim, kujdes shëndetësor dhe mbështetje ligjore

VKM NR 266 ,datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve"

Në ligjin 10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve përcaktohet jo vetëm ngritja e mekanizmave institucionale në nivel qendror dhe vendor për realizimin me efektivitet të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, por njëkohësisht edhe detyrimin e tyre për të bashkëpunuar më njëri- tjetrin në të gjitha nivelet, si një nga qëllimet kryesore të Ligjit nr 10 347.

VKM parashikon format e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ndërmjet institucioneve në të dy nivelet e qeverisjes, duke respektuar parimet, kompetencat dhe funksionet e njëri – tjetrit.

VKM NR 267,datë 12.04.2012 “Për Llojet, Mënyrën e Shkëmbimit të Informacionit dhe të Dhënave Statistikore të Kërkuara nga Agjencia e nga Strukturat Shtetërore Përgjegjëse, në Nivel Qendror dhe Vendor ”

VKM përcakton qartë burimet dhe llojin e të dhënave statistikore që do të mblidhen nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave për Fëmijët, duke synuar kështu të krijojë një bazë të plotë të dhënash për fëmijët.

Akte të tjera nënligjore

VKM Nr. 89, datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë”

VKM Nr.142, datë 23.2.2011”Për miratimin e "planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore" dhe të dokumentit plotësues "plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit”

VKM Nr. 582, datë 27.7.2011 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”.

KAPITULLI II. MEKANIZMAT INSTITUCIONALË

Ligji Nr.10347 datë 04.11.2010, për “Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve“, thekson ngritjen dhe funksionimin mekanizmave institucionalë të nevojshëm për zbatimin e ligjit dhe të të drejtave të fëmijëve. Ngritja e mekanizmave institucionalë në nivel qendror ka përfunduar tashmë dhe po punohet që njësitë e qeverisjes vendore të marrin përgjegjësitë e tyre në zbatim të ligjit, por edhe në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve:

Ne nivel qendror

- Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- Ministrin që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Në nivel vendor:

- Njësia për të Drejtat e Fëmijës në nivel qarku
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel bashkie/komune

Mekanizmat në nivel qendror

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (KKMDF), funksionon si një organ këshillimor pranë Këshillit të Ministrave. Në përputhje me programin e qeverisë ai koordinon dhe përcakton politikat që duhen ndjekur për fëmijët dhe monitoron zbatimin e strategjisë kombëtare për të drejtat e fëmijës. Këshilli analizon zbatimin e politikave dhe programeve për mbrojtjen e fëmijës dhe jep rekomandime për përmirësime të mëtejshme në këtë fushë. Ky organ ka në përbërje të tij 9 anëtarë, përfaqësues të ekzekutivit, të pushtetit vendor dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, parashikohet se pranë Këshillit do të ngrihen komitetet teknike, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin.

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, është ngritur, me Urdhër të Kyeministrit Nr.73, date 03.08.2011, në zbatim të Ligjit 10347 datë 4.11.2010.

Këshilli kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe ka në përbërje 13 anëtarë:

- Ministri i Brendshëm,
- Ministri i Arsimit dhe Shkencës,
- Ministri i Drejtësisë,
- Ministri i Shëndetësisë,
- Ministri i Integritit,
- Ministri i Financave,
- Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,
- Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
- Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve)
- 1 Përfaqësues nga Avokati i Popullit,

- 1 Përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive dhe
- 2 përfaqësues nga Shoqëria Civile

Në ligj parashikohen edhe detyrat e **Ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës**, i cili në referim të fushës së veprimtarisë që ushtrohet aktualisht, Ministri e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të jetë Ministri që do të mbulojë detyrat e parashikuara në nenet përkatëse.

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, që ka për këtë qëllim:

- hartimin e politikave dhe programeve shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës;
- propozon ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre,
- bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;
- orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e të drejtave të fëmijëve

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) është institucion ekzekutiv, në varësi të ministrit që bashkërendon punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr 30, dt 18.03.2011.

Detyrat e Agjencisë sanksionohen në ligj, ndërsa misioni i saj realizohet nëpërmjet funksioneve që vijojnë:

- të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” dhe legjislacionit në fuqi, si dhe të koordinimit të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- propozimit tek ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për ndërhyrje në politika dhe legjislacion, bazuar në problematikat që kanë dalë gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit, strategjive dhe politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- propozimit për udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
- të mbështetjes teknike, për strukturat e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe për organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- të koordinimit me të gjitha strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacionëve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- të ndëshkimit ndaj subjektëve të cilat shkelin dispozitat e ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.”

ASHMDF u plotësua me staf dhe filloi funksionimin në fund të majit 2011. Në përbërje janë 6 persona gjithësej, 5 staf dhe kryetarja. Kryetari i ASHMDF propozohet nga Ministri i Punës dhe emërohet në detyrë nga Kryeministri.

Struktura e ASHMDF:

1. Sektori për Mbrojtjen dhe Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve
2. Sektori i Koordinimit dhe Statistikës

ASHMDF ushtron aktivitetin e saj bazuar në rregulloren e institucionit të miratuar me VKM Nr 346 datë 29.04.2011 “Për miratimin e rregullores “ Për organizimin dhe funksionimin e ASHMDF”. Agjencia ka logon dhe vulën e saj të miratuar me Urdhër të Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr 1070 datë 12.07.2010.

Gjatë kësaj periudhë ASHMDF ka kontribuar në plotësimin e kuadrit nënligjor për zbatimin e ligjit. Në bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse në MPCSSHB, ka qënë bashkautore në hartimin e 5 VKM në zbatim të ligjit dhe një nga aktorët më të rëndësishëm për hartimin e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, dokumenti politik ku paraqitet strategjia që do të ndiqet për realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend.

Bazuar edhe në funksionet e saj, gjatë kësaj kohe ASHMDF ka punuar për sensibilizimin e aktorëve të ndryshëm lidhur me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe Planin e Veprimit për Fëmijë.

Fillimisht janë organizuar takime me NJD, NJMF, strukturat e shërbimeve sociale në të gjithë bashkitë/komunat e vendit, institucionet në nivel qendror dhe shoqërinë civile si aktorët që kanë përgjegjësi në mënyrë më të drejtpërdrejtë për zbatimin e ligjit.

Më pas ASHMDF ka vijuar takimet e sensibilizimit në qarqe, takime të cilat janë pasqyruar në mediat lokale dhe ato kombëtare. Pas përmbylljes së këtyre takimeve ASHMDF po harton një plan ndërhyrje për njohjen, shpjegimin e ligjit dhe akteve të tij nënligjore, të sapo miratuara, tek të gjithë aktorët në nivel vendor.

Mekanizmat në nivel vendor

Për të plotësuar kuadrin institucional, që ligji synon të krijojë me qëllim zbatimin efektiv të tij, është parashikuar ngritja e **Njësisë për të Drejtat e Fëmijës** në nivel qarku dhe **Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës** në nivel bashkie apo komune. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësisve do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duke filluar që në terren, pra nga baza e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit. Në respektim të parimit të autonomisë lokale, ligji ka parashikuar funksionimin e këtyre njësisve brenda organizimit administrativ të strukturave përkatëse të pushtetit lokal, me detyrat e parashikuara në ligj.

Ligji Nr.10347 datë 04.11.2010 sanksionon krijimin e Njësisve për të Drejtat e Fëmijës në çdo qark të Shqipërisë. NJDF funksionon si pjesë e strukturës administrative të Qarkut dhe ka për detyrë:

- a) të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;
- b) të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut;

- c) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile;
- d) të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark;
- dh) t'i raportojë këshillit të qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;
- e) t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në qark;
- ë) t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijës në qark.

Aktualisht janë ngritur **10 Njësi për të Drejtat e Fëmijëve** nga 12 qarqe që ka vendi. Në qarkun e Durrësit, është përcaktuar personi që do të jetë përgjegjës për NJDF dhe janë në zhvillim procedurat për miratimin e strukturës në Këshillin e Qarkut. Ndërsa në qarkun e Korçës nuk ka akoma përpjekje për ngritjen e NJDF dhe mbetet i vetmi qark në vend, që nuk ka njësinë për të drejtat e fëmijëve në strukturën administrative të tij.

Nga bashkëpunimi i deritanishëm rezulton se NJDF kanë luajtur një rol të rëndësishëm në vendosjen e çështjes së të drejtave të fëmijëve në agjendën e politikave rajonale të qarkut.

2 qarqe (Shkodër, Vlorë) tashme kanë miratuar strategjinë e tyre rajonale për të drejtat e fëmijëve, 4 qarqe (Elbasan, Dibër, Gjirokastrë, Kukës) janë duke punuar për hartimin e strategjisë dhe në 4 qarqe të tjera ka nisur puna për krijimin e grupit të punës që do të punojë për hartimin e strategjisë rajonale për fëmijët.

Në përgjithësi, NJDF në bashkëpunim edhe me Observatorët për të Drejtat e Fëmijëve, kanë pasur një rol aktiv për shpërndarjen dhe sensibilizimin e njësive të pushtetit vendor mbi legjisalcionin e ri dhe nxitjen e tyre për ngritjen e njësive për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF) të reja, bazuar në Ligjin Nr 10347 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” .

Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky ligj **Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve** në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë:

- a) të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet “jo në rrezik”;
- b) të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë multidisiplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës;
- c) të sensibilizojnë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;
- ç) të bashkëpunojë me administratorët e shërbimeve shoqërore, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

- d) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë/komunës mund të informohen apo të referohen te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;
- dh) t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;
- e) t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës.

Aktualisht në të gjithë vendin janë ngritur dhe funksionojnë **rreth 49 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve** që janë ngritur në 23 bashki dhe 26 komuna. Duke vënë në dukje se në kohën që u miratua Ligji “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” në të gjithë vendin ishin ngritur vetëm 18 NJMF, vlerësojmë se miratimi i kuadrit ligjor për fëmijët, duke institucionalizuar strukturat për fëmijët në nivel vendor, ka qënë një nxitje e rëndësishme për njësitë e qeverisjes vendore, në marrjen e përgjegjësisë për mbrojtjen e fëmijëve duke rritur ndjeshëm numrin e NJMF të reja. Ndryshimet e reja janë promovuar në qarqe dhe ka pasur ndryshime cilësore në perceptimin e të drejtave të fëmijëve nga institucionet dhe shoqëria, megjithëse këto ndryshime nuk kanë ndodhur me të njëjtin ritëm për të gjithë.

Pothuajse të gjitha bashkitë e mëdha në vend e kanë ngritur këtë shërbim për fëmijët, përveç bashkisë Tiranë, tek e cila nga 11 minibashki, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve janë ngritur në vetëm 2 prej tyre.

Nga të dhënat e fundit të grumbulluara nga NJMF rezulton se për periudhën 2011-2012, vetëm nga **16 NJMF** kanë marrë shërbim dhe janë trajtuar **gjithsej 953 fëmijë**, nga këto 152 raste kanë qënë fëmijë të rinj të identifikuar dhe 142 raste janë mbyllur duke u konsideruar jo në rrezik.

Shumë bashki e komuna janë pro-aktive në mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve në rrezik, megjithatë edhe ata vetë pranojnë se duhet bërë më shumë nga të gjithë aktorët në nivel lokal.

Mirëfunksionimi i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve varet veçanërisht nga autoritetet lokale, të cilët duhet të njohin rolin dhe përgjegjësitë e tyre për të siguruar kujdes dhe mbrojtje për fëmijët dhe të koordinojnë veprimet e tyre me aktorët e tjerë vendorë të angazhuar në çështjet e mirëqenies së fëmijëve

Ngritja e NJMF në të gjithë vendin mbetet një sfidë e rëndësishme, po tashmë vëmendja duhet të kthehet gjithashtu edhe në rritjen e kapaciteteve dhe mirëfunksionimin e NJMF të ngritura.

KAPITULLI III. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SITUATËN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

KUJDESI SHËNDETËSOR

Sigurimi i kujdesit esencial shëndetësor për nënën dhe fëmijën

Sipas vlerësimit të bërë nga UNICEF, Banka Botërore, OBSH, Levels & Trends in Child Mortality, Report 2011, Estimates Developed by the UN Inter-agency Group for Child Mortality Estimation, vdekshmëria foshnjore në Shqipëri është ulur nga 36 për 1000 lindje gjallë në 16 për 1000 lindje gjallë për vitin 2010, dhe vdekshmëria nën 5 vjeç është ulur nga 40/1000 lindje gjallë në 14 për 1000 lindje gjallë.

Sipas statistikave të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin 2011 vdekshmëria foshnjore është 8.7 vdekje për 1000 lindje gjallë dhe vdekshmëria amtare është 5.8 vdekje në 100 mijë lindje gjallë. 97% e grave shtatzënë kanë marrë vizitën e parë brenda tremujorit të parë të shtatzënisë dhe 98% e grave asistohen nga personel mjekësor gjatë lindjes.

Gjatë vitit 2011, i është kushtuar vëmendje përmirësimit të infrastruktuës në maternitete, nëpërmjet pajisjes së tyre me sete aparaturash mjekësore bashkëkohore, që synojnë uljen e mortalitetit foshnjor dhe amtar, duke ndikuar njëherësh në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Maternitetet në 16 rrethe të vendit janë pajisur nëpërmjet një investimi në mbi 110 mijë dollarë, të UNFPA. Në kuadër të këtij projekti janë përmirësuar pajisjet mjekësore në maternitetet e rretheve Pukë, Mirditë, Kurbin, Kukës, Tropojë, Has, Dibër, Skrapar, Burrel, Gramsh, Korçë, Pogradec, Sarandë, Fier, Vlorë dhe Berat, duke mundësuar që dhe në këto rrethe cilësia e shërbimit të ofruar të jetë e njëjtë me të spitaleve qendrore të Tiranës.

Në bashkëpunim me OBSH u adoptua protokollin për vlerësimin e cilësisë së kujdesit për nënën dhe të porsalindurin në maternitete. Ky protokoll është një mjet i unifikuar për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të kujdesit për lindjen dhe foshnjën e porsalindur mbi bazën e standarteve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2011 janë trajnuar 65 punonjës të personelit shëndetësor të materniteteve Shkodër, Korçë, Vlorë lidhur me sigurimin e kujdesit esencial për gruan shtatzënë dhe foshnjën e porsalindura përfshirë reanimacionin, kontrollin e temperaturës dhe fillimin e hershëm të ushqyerjes me gji.

Ka filluar puna për përgatitjen e protokolleve për kujdesin për gruan shtatzënë dhe kujdesin për të porsalindurin, nëpërmjet bashkëpunimit me departamentin e obsterik gjinekologjisë dhe pediatriisë së fakultetit të Mjeksisë dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve në Ministrinë e Shëndetësisë.

Aktualisht MSH ka filluar riorganizimin e shërbimeve të nënës dhe fëmijës (këshillimoret e nënës dhe fëmijës) në kujdesin shëndetësor parësor me mbështetjen e UNICEF dhe eksperteve ndërkombëtarë. Është hartuar një plan veprimi që përcakton aktivitetet që do të ndërmerren

gjatë viteve 2012-2015 me qëllim organizimin më efektiv të kujdesit shëndetësor parësor të nënës dhe fëmijës, bazuar në standarde cilësie, udhërrëfyes dhe protokolleve klinike për konsultoret e nënës dhe fëmijës

Ushqyerja me gji

Në vendin tonë janë rreth 8 maternitete të çertifikuara si institucione që promovojnë praktikën më të mirë të Iniciativës "Spitale Mike të fëmijës" të OBSH/UNICEF që përputhen me 10 hapat e ushqyerjes me gji. Së fundmi është bërë vlerësimi i materniteteve të rretheve Shkodër, Korçë, Kukës, për t'i çertifikuar si institucione që mbrojnë dhe nxisin ushqyerjen me gji.

Gjatë periudhës 2011-2012 janë zhvilluar trajnime për rreth 40 punonjës të rretheve, lidhur me praktikën e ushqyerjes së suksesshme me gji dhe krijimin e spitaleve mike të fëmijës me personelin në maternitetet dhe konsultoret e nënës dhe fëmijës në Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë, Shkodër.

Në kuadrin e projektit të përmirësimit të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve të kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën, në bashkëpunim me USAID, gjatë vitit 2011 është bërë një vlerësim i situatës së të gjithë treguesve që aktualisht mbledh sistemi shëndetësor dhe gjatë vitit 2012 do të punohet për rishikimin e tyre. Në treguesit e rinj për monitorimin, që pritet të përfundojnë në vitin 2013, mendohet të përfshihen edhe tregues të rinj si psh ushqyerja me gji.

Ne 3 mars 2012 u hap fushata sensibilizuese për Mënyrat e reja dhe më të mira të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve në Shqipëri, fushatë që synon përmirësimin e shëndetit dhe zhvillimit të fëmijëve dhe të kontribuojë në përmirësimin e qëndrueshëm të praktikave të ushqyerjes së fëmijëve dhe reduktimin e kequshqyerjes.

Fushata e komunikimit ka si synim të përmirësojë mënyrën e këshillimit të personelit shëndetësor mbi praktikën e rekomanduar të ushqyerjes së fëmijëve (bazuar në rekomandimet e OBSH dhe UNICEF), të krijojë një mjedis mbështetës në familje për nënat dhe për mënyrat e reja të ushqyerjes dhe të kujdesit që këto praktika të jenë të vazhdueshme.

Pjesë me rëndësi e kësaj fushate do jetë edhe promovimi ushqyerjes me gji veçanërisht ushqyerjes ekskluzive me gji vetëm për 6 muajt e parë të jetës

Parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët

Në kuadër të aktiviteteve të programit kombëtar të nutricionit për vitin 2011:

- Futja e kurbave të reja të monitorimit të rritjes sipas OBSH,
- Përfundimi moduleve të integruara të trajnimit të stafit mbi ushqyerjen, trainimi i trajnuesve kombëtarë

Modulet e reja të trajnimit japin informacion mbi kurbat e reja të rritjes nga OBSH, bazat e ushqyerjes, ushqyerja e gruas shtatzënë dhe ushqyerja e fëmijës. Këto module janë përpiluar për punonjësit e shëndetësisë të KSHP, të cilët masin dhe vlerësojnë rritjen e fëmijëve, ushqyerjen,

apo mbikqyrin këto aktivitete si p.sh: pediatër, mjekë të familjes, infermierë, zyrtarë të sistemit shëndetësor dhe nutricionistë, të cilët punojnë në sektorin publik dhe atë privat.

Synimi është rritja e aftësive dhe njohurive të nevojshme për:

- Vlerësimin e rritjes në raport me standardet e reja të rritjes sipas OBSH;
- Këshillimin e nënave mbi ushqyerjen dhe mirërritjen.
- Të kuptohet rëndësia e vlerësimit periodik të rritjes së fëmijëve, në përcaktimin e humbjes së peshës, rritjes së pamjaftueshme në gjatësi, peshës së tepërt/obezitetit etj.

Në fillim u trajnuan 16 persona të cilët janë edhe trajnuesit kombëtarë dhe më tej u vazhdua me trajnimet 4 ditore për kurbat e rritjes në 2 rajonet Kukës, Shkodër si dhe Kamzë e Paskuqan, (qershor- korrik, 2011).

Gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2011 u trajnuan në trajnime 8 ditore, për ushqyerjen e fëmijës dhe ushqyerjen e gruas shtatzënë personeli shëndetësor i qarqeve Kukës, Shkodër (6 rrethet).

Personeli i trajnuar janë mjekët e familjes që mbulojnë shërbimin për nënën dhe fëmijën në zonën e tyre të mbulimit, infermieret/mamitë e patronazhit të QSH, personeli i konsultorit të fëmijës dhe konsultorit të gruas.

Përveç trajnimit të personelit shëndetësor kanë filluar fushatat e informimit, edukimit, komunikimit në shkolla dhe media për rritjen e aktivitetit fizik dhe ushqyerjen e shëndetshme tek fëmijët dhe adoleshentët.

Instituti i Zhvillimit Arsimor, i MASH i mbështetur nga Unicef, në bashkëpunim me ISHP ka ngritur një grup ekspertësh prej dy instituteve që po punojnë për paketën kurrikulare për edukimin e ushqyerjes së shëndetshme në arsimin e detyruar (Klasa 1-9).

Në Mars 2012, u lançua fushata sensibilizuese për “*Mënyrat e reja dhe më të mira të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve në Shqipëri*”, që synon përmirësimin e shëndetit dhe zhvillimit të fëmijëve dhe të kontribuojë në përmirësimin e qëndrueshëm të praktikave të ushqyerjes së fëmijëve dhe reduktimin e kequshqyerjes.

Në kuadër të bashkëpunimit të Qeverisë me OKB, Për reduktimin e Kequshqyerjes për Fëmijët u miratua me Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë Nr.86, dt.20.02.2012, “Dokument i Strategjik i Komunikimit Për Ushqyerjen”, nëpërmjet të cilit synohet që:

- problemet e ushqimit, të sigurisë ushqimore të bëhen më të rëndësishme në axhendën e qeverisë, duke ndihmuar dhe në hartimin e ndërhyrjeve të fokusuara drejtpërdrejt në grupet e popullsisë që preken më shumë nga këto probleme.
- të arrihet një komunikim intensiv rreth ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve në Shqipëri, duke synuar ndryshimin e qëndrueshëm të sjelljes së njerëzve dhe jo thjesht informimin e tyre.

Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë vazhdon të jetë më ritme të kënaqshme. Për vitin 2011 mbulesa vaksinale e fëmijëve sipas vaksinave:

- 97 % - Hep B, BCG në lindje

- 99% - DTP- Hib – HepB 3 (difiteri-tetanoz, pertusis, hemofilus influenze, hepatiti B)
- 99% - Pneumo 3
- 99% - OPV 3 (poliomielit)
- 98% - FRP (fruth rubeolë parotit)

Në kuadër të zgjerimit të skemës së kalendarit të vaksinimit janë futur disa vakcina të reja në kalendarin rutinë:

- Vaksina e pneumokokut në vitin 2011 (Pneumo 10 valent)
- Vaksina Hib (pentavalente DTP-Hib -Hep b ne vitin 2009

Ne vitin 2011 është futur në skemën e vaksinimit, vakcina kundër pneumokokut, një vaksinë e re, e cila është blerë tërësisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe që përbën një investim dhe hap të rëndësishëm në luftën ndaj sëmundjeve dhe vdekjeve të moshës foshnjore.

Rreth 1450 punonjës të personelit shëndetësor janë trajnuar lidhur me imunizimin, vaksinat e reja, sigurimin e zinxhirit ftohës dhe sistemin e raportimit.

Ka filluar puna për përmiresimin dhe unifikimin e sistemit të regjistrimit të vaksinave të fëmijëve, nëpërmjet futjes së regjistrimit elektronik të vaksinimit të popullatës. Si fillim ky regjistër ka nisur të funksionojë në qytetin e Shkodrës për t'u përhapur më pas në qarqe të tjera të vendit. Avantazhet janë se përmes kartës së identitetit çdo prind, kudo që ndodhet në vënd, do të mund të gjejë si dhe sa vakcina ka kryer fëmija dhe vaksinat që duhet të marrë akoma.

Përfshirja në kalendarin e vaksinimit të grupeve të marginalizuara, si popullata rome, vazhdon të jetë një nga detyrat e punonjësve të kujdesit shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me organizatat Rome, kanë krijuar një bazë të dhënash me zonat e banuara nga komuniteti Rom (hartë e zonave Rome) në të gjithë vendin. Kështu, të gjitha Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve janë udhëzuar që të kenë në vëmendje të veçantë edhe trajtimin shëndetësor të kësaj popullate. Gjatë 2011 janë kryer fushata vaksinimi të fëmijëve në komunitetet rome në Tiranë, Shkodër, Fier

Përveç vaksinimit janë ndërmarrë edhe fushata informimi në shkolla dhe komunitet për parandalimin e sëmundjeve infektive, higjienën ushqimore, personale dhe të mjedisit, masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve ngjitëse, etj. Këto aktivitete kanë synuar:

- parandalimin e pneumonive dhe infeksioneve pneumokoksike
- parandalimin e gripit sezonal
- parandalimin e HIV tek gruaja shtatzënë
- parandalimin e etheve hemorragjike të Krime Kongos në zonat veriore

Zgjerimi MISF (Menaxhimi i Integruar i Sëmundjeve të Fëmijërisë) në komunitetet me status të ulët social ekonomik

Ndërhyrjet e MISF komunitar do të kenë si qëllim reduktimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë foshnjore dhe fëmijore në komunitetet më vulnerabël.

Për të realizuar efektivisht këtë program janë zgjedhur komunat me popullsi më të madhe dhe me numër më të madh të fëmijëve të moshës 0-5 vjeç dhe ato komuna ku ka pasur dhe

sëmundshmëri të lartë të moshës femënore. Për vitin 2011 MISF komunitar ndërhyri në rajonin e Korçës dhe gjatë 2012 do të fillojë me disa komuna në rajonin e Durrësit.

Objektivat e ndërhyrjes përfshijnë:

- Rritjen e kapaciteteve të individit dhe familjes për përmirësimin e praktikave të përkujdesjes për fëmijët, përfshirë dhe kujdesin në shtëpi për fëmijët e sëmurë të moshës 0-5 vjet.
- Sigurimi i pjesëmarrjes së komunitetit në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të shërbimit shëndetësor nëpërmjet pjesëmarrjes në bordet e shëndetit
- Rritja e kapaciteteve të vullnetarëve të shëndetit për të ofruar këshillim për problemet e mirëritjes së fëmijeve.

Ndërhyrjet do të synojnë në përmirësimin e njohurive dhe praktikave për ushqyerjen korrekte të fëmijëve dhe kujdesin gjatë shtatzënisë: ushqyerja me gji dhe ajo plotësuese, përdorimi i kripës së jodizuar, përdorimi i ushqimeve të pasura në hekur, higjiena; njohjen e shenjave të rrezikut për infeksione akute respiratore, diarre, kërkimi në kohë i ndihmës mjekësore dhe kujdesi për fëmijën e sëmurë në shtëpi, imunizimi, kujdesi për gruan shtatzënë.

Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për MISF është 70 mjekë dhe 40 infermiere të kujdesit shëndetësor parësor në Korçë dhe 45 mjekë familje në Durrës

Në nëntor 2011 ka filluar puna me komunitetet e 5 komunave të përzgjedhura të Korçës që kanë gjithësej 62045 banorë dhe 2766 fëmijë 0-5 vjeç.

Kontrolli dhe parandalimi HIV/AIDS dhe IST

Në periudhën 2011-2012 janë identifikuar 4 raste të reja të fëmijëve me HIV/AIDS, të infektuar nga transmetimi vertikal nga nëna te fëmija.

Aktualisht në vendin tonë janë vetëm 2 qendra reference pranë ISHP-së dhe QSUT.

Ende është në proces diskutimi ngritja e qendrave të referencës nëpër maternitete për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS nga nëna te fëmija. Në maternitete mund të kryhet testimi me kite të shpejta, por nuk mund të konsiderohen qendra reference për trajtimin e rasteve me HIV/AIDS.

Gjatë këtij viti, fëmijët me HIV/AIDS janë trajtuar nga Shërbimi i Pediatriisë në QSUT dhe rasti i një gruaje shtatzënë është trajtuar nga Shërbimi Infektiv në QSUT për parandalimin e transmetimit të virusit nga nëna te fëmija.

Duke ndjekur hapat e zhvillimit të infeksionit në vend, ndryshimet politike dhe socio-ekonomike si dhe shkallën e ndërgjegjësimit të organeve shtetërore politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr 113 datë 17.02.2011, "Rregullat për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS-it dhe për kujdesin, këshillimin dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS në institucionet e arsimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, burgjet dhe vendet e paraburgimit"

Hartimi i rregullave të veçanta për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit HIV në institucionet e lartpërmendura është një domosdoshmëri, pasi prania e shumë faktorëve socialë, ekonomikë dhe kulturorë i bëjnë popullatat e këtyre institucioneve vulnerabël ndaj këtij infeksioni.

Në parandalimin e përhapjes së virusit, mënyrë të veçantë theksohet informimi dhe edukimi i popullatës për përdorimin e mjeteve parandaluese dhe përdorimin e shërbimeve ekzistuese për

kujdesin ndaj HIV si: shërbime të këshillimit dhe testimit vullnetar, kujdesi mjekësor për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

Është i nevojshëm një promovim më i gjerë dhe më i madh për Testimin Vullnetar. Testimi i pacientëve, fëmijë apo të rriturve, lidhur me HIV/AIDS është e nevojshme të jetë në rregulloren e brendshme të spitaleve apo poliklinikave, ashtu siç është testimi dhe për sëmundje të tjera. Njëkohësisht është e domosdoshme që personeli shëndetësor të kujdeset edhe për rrisqet ndaj vetes së tyre.

Në kuadër të fushatës informuese, edukuese për parandalimin dhe përhapjen e HIV/AIDS në moshën femënore dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS, janë trajnuar rreth 500 mësues në të gjithë vendin lidhur me edukimin seksual dhe mijëra paketa informuese janë përgatitur dhe do të shpërndahen në muajt në vijim.

Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës së bashku me Kombet e Bashkuara prezantuan në 15 Nëntor 2011 fushatën e re sensibilizuese për parandalimin e përhapjes së HIV/SIDAS në Shqipëri. Fushata, e cila është e bazuar mbi modelin KOMBI (komunikim për ndryshim të sjelljes), i drejtohet grupmoshave të ndryshme duke u fokusuar tek sjelljet e mbrojtura seksuale. Fushata fokusohet në edukimin e dy sjelljeve të rëndësishme: shtyrjen e marrëdhënieve të para seksuale mes të rinjve dhe rritjen e përdorimit të prezervativit nga meshkujt. Profesionistë shqiptarë nga fusha e shëndetësisë dhe arsimit kanë drejtuar punën në terren.

ARSIMI

Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor, për fëmijët

Në zbatim të Planit të Veprimit për Fëmijë, MASH ka udhëzuar të gjitha DAR/ZA, shkollat dhe institucionet vartëse për programimin e aktiviteteve vjetore dhe realizimin e tyre në zbatim të objektivave strategjike.

Buxheti për arsimin bazë për vitin 2011 ishte 23.636 milion lekë dhe zë rreth 61% të fondeve të buxhetit të shtetit për arsimin.

Në politikat arsimore të MASH po i kushtohet vëmendje arsimit parashkollor. Përfshirja me prioritet të fëmijëve 5-vjeçarë në të paktën një vit përgatitor, lehtëson mësimnxënien në klasën e parë.

Gjatë vitit shkollor 2011-2012 janë hapur 200 klasa përgatitore që frekuentohen nga 5000 fëmijë 5 vjeçarë që për herë të parë ndjekin një edukim të institucionalizuar. 87% e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë ndjekin të paktën 1 vit përgatitor.

Përmirësimi i kushteve në shkolla, ndërtimi i shkollave të reja, rehabilitimi i atyre ekzistuese. Investimet dhe ndërhyrjet me reforma në arsimin bazë po përqendrohen në sigurimin e një arsimi cilësor për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies. Në veçanti, i është kushtuar vëmendje modernizimit të infrastrukturës fizike (rehabilitimi dhe ndërtimi i kopshteve dhe shkollave të reja me standarde evropiane) dhe pajisjes me laboratorë shkencorë dhe laboratorë të teknologjisë së informacionit (IT) me një kompjuter për dy nxënës dhe zgjerimit të arsimit parashkollor.

Gjithëpërfshirje në mësimnxënie. Ulja e braktisjes shkollore

Ndjekja dhe regjistrimi i fëmijëve rom në kopshte dhe arsimin e detyruar është një ndër objektivat strategjike të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, të “Programit kombëtar për braktisjen zero” dhe të Planit të Veprimit Për Dekadën Rome.

Gjatë vitit 2012, pritet të miratohet Ligji i ri “Për sistemin arsimor parauniversitar”, ku për herë të parë sanksionohet:

- Personalizimi i kurrikulës së hartuar dhe të zbatuar për nxënësit me nevoja të veçanta në përshtatje me zhvillimin fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësit.
- Hartimi i programit të personalizuar për nxënësit me AK nga një komision, brenda shkollës i përbërë nga mësues të fushave të ndryshme të të nxënës, psikologu, specialist për fëmijët me nevoja të veçanta si dhe prindërit.
- Pajisja me përparësi e nxënësve me AK me mjetet e përshtatshme të mësimin dhe të nxënies, mjetet e tjera ndihmëse, përfshirë dhe ato të teknologjisë së përditësuar të informacionit dhe komunikimit.
- Sigurimi me përparësi i mësuesit ndihmës në klasat ku mësojnë fëmijët me AK

Gjatë vitit shkollor 2011-2012 është realizuar shpërndarja e teksteve falas për fëmijët e familjeve të varfëra, që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe fëmijët rom që ndjekin arsimin e detyruar, duke eliminuar një nga barrierat për arsimimin e tyre .

Ulja e braktisjes shkollore është një ndër objektivat kryesore të politikës arsimore të MASH që realizohet nëpërmjet “Planit Kombëtar të braktisjes zero 2009-2013”.

Treguesi zyrtar i braktisjes shkollore vlerësohet të jetë 0.43%.

Në nivel kombëtar, Iniciativa Braktisja Zero ka në shënjestër të gjithë fëmijët dhe adoleshentët e arsimit para-shkollor, të ciklit të ulët dhe të lartë të arsimit bazë që kanë braktisur shkollën, nuk janë regjistruar ndonjëherë ose janë në rrezik për braktisje. Në qarqet pilot, ndërhyrjet do të kenë në shënjestër shkolla të identifikuar nga partnerët lokalë që kanë numrin më të madh të braktisjeve dhe të nxënësve në rrezik për braktisje.

Qëllimi gjithëpërfshirës i iniciativës është të pakësojë numrin e largimeve të hershme nga shkolla për të siguruar që të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjendja ekonomike, të përfundojnë arsim bazë.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në plan është krijuar sistemi i mbledhjes dhe monitorimit të frekuentimit të nxënësve në të gjithë DAR/ZA.

Fenomeni i braktisjes së shkollave është më i përhapur tek fëmijët rom. 61 për qind e familjeve rome kanë deklaruar se ata përballen me vështirësi në edukimin e fëmijëve. Ata listojnë disa arsye, të cilat lidhen kryesisht me varfërinë, mungesën e veshjeve të përshtatshme, kushtet e këqija të jetesës, mungesën e infrastrukturës, nevojën e kontributit të fëmijëve në rritjen e të ardhurave të familjes, kujdesi për motrat dhe vëllezërit më të vegjël etj. Pavarësisht nga çështjet e përmendura më lart, ka edhe pengesa institucionale si dhe barrierë që kanë të bëjnë me traditat rome dhe kulturëne tyre.¹

Migrimi i brendshëm ose migrimi sezonal i familjeve rome ndikon negativisht në edukimin e fëmijëve. Në këto raste, fëmijët braktisin shkollën përpara përfundimit të vitit akademik dhe shumë prej tyre e braktisin atë përfundimisht.

Distanca e shkollës nga banesa dhe diskriminimi, niveli i ulët arsimor i prindërve janë edhe këto arsye që pengojnë arsimimin e fëmijëve rom.

Diskriminimi është i shprehur kryesisht në formën e sjelljeve vulgare dhe fyerjeve verbale dhe shumë rrallë përmes refuzimit të shërbimit.

Për shkak të nivelit të ulët të tyre arsimor, shumë prindër rom nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre me mësimet në shtëpi. Megjithatë është në rritje numri i familjeve rome që vlerësojnë rëndësinë e edukimit të fëmijëve dhe në familjet rome me nivel të mirë ekonomik fëmijët e tyre ndjekin shkollën rregullisht².

Edukimi parashkollor është i rëndësishëm për edukimin e fëmijëve dhe sidomos për fëmijët rom. Aktualisht kopshtin e frekuentojnë 560 fëmijë rom parashkollorë dhe arsimin bazë e frekuentojnë 3435 fëmijë rom të moshës së arsimit të detyruar.

Fëmijët rom të cilët kanë ndjekur kopshtin përshtaten më mirë me mjedisin shkollor dhe kur regjistrohen në shkollën fillore kanë më pak vështirësi në arritjen e njohurive të reja. Edukimi parashkollor si dhe njohja më e mirë e gjuhës shqipe janë elementë të rëndësishëm për arsimimin në të ardhmen.

Duke parë që një nga pengesat e arsimimit është varfëria, MASH po studion mundësinë për ofrimin e vakteve ushqimore në shkolla për fëmijët. Një grup pune është duke vlerësuar mundësi të ndryshme për ofrimin e këtij shërbimi. Gjatë këtij viti ka filluar pilotimi i shkollës me një vakt

¹ Studim UNICEF dhe Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale “Hartëzimi i fëmijëve rom” nëntor 2011

² Studim UNICEF dhe Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale “Hartëzimi i fëmijëve rom” nëntor 2011

ushqimor në shkollën 9-vjeçare Naim Frashëri në Korçë, ku ka një përqindje të madhe të fëmijëve rom që frekuentojnë këtë shkollë.

66% e nxënësve që ndjekin klasat e “Shansit të dytë” janë rom. IZHA po punon për studimin e dokumentacionit ligjor në fushën e arsimit për romët në Shqipëri dhe në vende të tjera të rajonit, përvoja të huaja në lidhje me përfshirjen e kulturës rome në edukim.

Do të hartohet një udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit për t’u lehtësuar atyre punën me fëmijët rom dhe me prindërit e këtyre fëmijëve. Ky udhëzues do të shoqërohet me materiale mbështetëse në ndihmë të drejtuesve, mësuesve dhe prindërve për punën me nxënësit rom. Është e nevojshme gjithashtu dhe do të punohet edhe për kualifikimin e mësuesve që punojnë me fëmijët rom.

Gjatë vitit shkollor 2011-2012 vlerësohet të ketë një rënie të konsiderueshme të numrit të fëmijëve të ngjuar. Nga 86 fëmijë të ngjuar në vitin shkollor 2008 – 2009, në vitin shkollor 2011-2012 rezultojnë 35 fëmijë të ngjuar. Këtyre fëmijëve u është siguruar arsimimi, sipas nivelit të shkollimit, në shtëpi.

MBROJTJA SOCIALE

Rritja e rolit të njësisve të qeverisjes vendore, në vlerësimin e nevojave të fëmijëve në raport me realizimin e të drejtave të tyre dhe zbutjen e varfërisë.

Në kuadër të reformës për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe reformës së shërbimeve sociale u miratua ligji nr. 10 399, datë 17.3.2011”Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të cilat lidhen me:

- zgjerimin e grupeve përfituese si viktimat e dhunës në familje dhe jetimët;
- administrimin më të mirë të programit të ndihmës ekonomike,
- sigurimin e përfshirjes sociale dhe mos diskriminimin e disa individëve dhe grupeve në nevojë;
- funksionalitetin e shërbimit të kujdestarisë në familje si shërbim alternativ për fëmijët

Ndryshimet ligjore i kanë hapur rrugë pilotimit të skemave të reja të shpërndarjes së NE. Ndihma ekonomike do të kushtëzohet me pjesëmarrjen në punë apo shërbime, të cilat kontribuojnë në një targetim më të mirë të individëve në nevojë, mbulim me të ardhura më të larta për familjen, përfitimin e komunitetit ku ofrohen këto punë apo shërbime, reduktimin e nivelit të varfërisë dhe realizimi i kthimit të skemës së NE nga skemë pasive, në një skemë aktive.

Po ashtu ky përmirësim i ligjit, përcakton mbështetjen me një pagesë shtesë mbi atë të parashikuar për strukturën e familjes, për fëmijët e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike të cilët ndjekin arsimin e detyrueshëm, duke pasur parasysh që të inkurajojë familjet përfituese të NE për të dërguar fëmijët në shkollë, këto familje duhet të stimulohen për ta bërë këtë gjë.

Në fillim të 2011, me urdhër të Ministrit, u ngrit grupi i punës me përfaqësues të MPCSSHB, SHSSH dhe përfaqësues të ministrive të tjera si Ministria e Arsimit, Ministria e Brendshme, Ministria Shëndetësisë, Minsitria e Integritit, Minsitria e Financës, të koordinuar dhe mbështetur teknikisht nga një ekspert i huaj, të cilët hartuan draft-projektin e planit të veprimit për reformimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.

Ky draft-projekt i planit të veprimit të reformimit të shërbimeve sociale, përfshin veprime konkrete për rregulloret, politikat, strukturat, procedurat, kapacitetet, sistemet dhe shërbimet sociale që synojnë të mbrojnë grupet dhe individët në nevojë. Ky dokument, në vazhdimësi të procesit të decentralizimit dhe deinsitucionalizimit, përfshin shërbimet shëndetësore, arsimore etj në nivel vendor, siguron një mundësi për t’i dhënë formë së ardhmes së shërbimeve sociale në Shqipëri në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të integruar. Pritet të lançohet në shtator të vitit 2012.

Deinsitucionalizimi - Transformimi i shërbimeve rezidenciale në tipologji të reja shërbimesh

Duke ju referuar të dhënave statistikore të Shërbimit Social Shtetëror, numri i pranimeve në

institucione është ulur çdo vit. Institucionet, bazuar edhe në zbatimin e standarteve të cilësi së shërbimit, kanë pasur si prioritet të punës së tyre edhe hartimin e planeve të përkujdesit për nxitjen e integritit të fëmijëve, rikthimin e tyre në familjen biologjike ose birësimin.

Gjatë vitit 2011 në institucione publike dhe jopublike me Vendim Komisioni janë pranuar 103 fëmijë (70 fëmijë në institucione publike dhe 33 jo publike). Gjatë periudhës Janar - Maj 2012 janë pranuar 20 fëmijë me vendim komisioni nga Shërbimi Social Shtetëror

Gjatë vitit 2012, në rrjetin e institucioneve publike dhe jo - publike të përkujdesit shoqëror janë trajtuar:

- 595 fëmijë - në institucione rezidenciale përkujdesi për fëmijë, nga këto:
266 fëmijë (në 9 institucionet publike)
329 fëmijë (në 15 institucione jopublike);
- 1609 fëmijë në shërbime ditore/komunitare, nga këto:
70 fëmijë (në 3 institucione publike)
1539 fëmijë (në 27 qendra ditore jopublike)
- 37 fëmijë të trajtuar në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje ,
35 fëmijë të shoqëruar nga nëna dhe 2 fëmijë të pashoqëruar. (Prill 2011- Maj 2012)
- 87 fëmijë me aftësi të kufizuar të trajtuar në 7 Qendrat e Zhvillimit.

Në kuadër të reformës së sistemit të mbrotjes sociale, janë bërë përpjekje për konceptin e ri të shërbimeve rezidenciale të formës shtëpi – familje dhe ofrimit të shërbimeve alternative si kujdestaria dhe birësimi.

Gjatë vitit 2011, janë birësuar 27 fëmijë që jetonin në institucione rezidenciale (16 fëmijë nga institucionet publike dhe 11 fëmijë nga institucionet jopublike). Nga këta 19 fëmijë janë birësuar brenda vendit dhe 8 të tjerë jashtë vendit.

Ka filluar transformimi fizik i ambjenteve të shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç " Zyber Hallulli" në Tiranë në formën e shërbimit shtëpi-familje. Ky projekt mundësohet me fonde të buxhetit të shtetit dhe pritet të përfundojë në gusht 2012.

Ambjentet do të organizohen në 4 apartamente ku do të jetojnë fëmijët e ndarë sipas grupmoshave 6- 10 vjeç dhe 10- 15 vjeç në përputhje me nevojat dhe marrëdhëniet ndërpersonale që i karakterizojnë. Kjo formë shërbimi synon të shtrihet edhe në institucionet e tjera rezidenciale publike.

Aktualisht në gjithë rrjetin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë ekzistojnë rreth 12 shërbime të tipit Shtëpi –Familje jopublike dhe 3 shërbime të tilla publike.

Qendrat e transformuara do të ofrojnë edhe lloje të tjera shërbimesh alternative në strukturat rezidenciale të përkujdesit për fëmijë, dhe konkretisht shërbime ditore, këshillimore për fëmijët, familjet e tyre dhe shërbime në komunitet.

Shtëpia e Foshnjës 0-3 vjeç Shkodër funksionon si Qendër Ditore dhe Këshillimi për nënat dhe fëmijët e komunitetit ku përfitojnë 24 fëmijë që përfitojnë shërbim ditor si dhe shtëpi-familje për 11 fëmijë që përfitojnë shërbim rezidencial.

Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Durrës ofron shërbime sociale edhe nëpërmjet shërbimeve të tjera alternative si shtëpi- familje. Aktualisht trajton 24 fëmijë të qendrave rezidenciale të ndarë në dy shtëpi familje dhe 30 fëmijë të qendrave ditore, nga familje me probleme sociale ekonomike nga komuniteti.

Shtëpia e fëmijës 3-6 vjeç Shkodër, ofron 2 lloj shërbimesh: shërbime rezidenciale për 28 fëmijë të ndarë në shtëpi – familje të vogla për fëmijë që janë të një gjaku (motra-vllëzer) dhe shërbime ditore për 25 fëmijë kryesisht të komunitetit rom - egjiptian.

Shërbim këshillimi social për nënat-vajza për të parandaluar institucionalizimin e fëmijëve ofrohet në dy Maternitetet e Tiranës nga dy punonjëse sociale të cilat bëjnë pjesë në strukturat e Shtëpisë së Fëmijës Tiranë dhe në bashkëpunim me "Bethany Christian Services" ofrohet këshillim edhe për rastet e veçanta pas abortit.

Mbi moshën 15 vjeç shërbimet mbështetëse për këto fëmijë janë të pakta dhe nuk plotësojnë nevojat.

Ofrimi i shërbimeve në formën shtëpi-familje, ka filluar të implementohet edhe në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë me aftësi të kufizuara, në Qendrat e Zhvillimit në Vlorë, Shkodër, Tiranë.

Ngritja e shërbimeve të reja shoqërore në komunitet

Në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë që përcakton Ligji nr. 9355, dt. 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, njësitë e qeverisjes vendore identifikojnë nevojat dhe në përputhje me këto nevoja do të ngrenë lloje të reja shërbimesh shoqërore.

Vërehet se njësitë e qeverisjes vendore nuk po marrin rol aktiv në ngritjen e shërbimeve të reja, duke e konsideruar këtë si detyrë të qeverisjes qendrore. Për këtë arsye MPÇSSHB nëpërmjet ndryshimeve ligjore të realizuara në ligjin 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar (të miratuara më Ligjin nr. 10 399, date 17.3.2011”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”) lejon dhe nxit njësitë e pushtetit vendor të ndërrmarin nisma për ngritjen e shërbimeve sociale në komunitetin e tyre duke përdorur 3% të fondit të mbrojtës sociale të deleguar pranë njësisë të pushtetit vendor nga buxheti i shtetit me kusht që t’i shtojnë këtij fondi edhe një përqindje nga fondi i buxhetit të të ardhurave të vetë njësisë.

Në mars 2012 është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Harta e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, një hartë elektronike që ofron informacion të plotë dhe të përditësuar rreth numrit të shërbimeve në vend, shtrirjes gjeografike të tyre, tipologjisë dhe kapaciteteve.

Kujdestaria

Shërbimi i kujdestarisë është pilotuar gjatë 2011 në dy bashki (Tiranë, Shkodër) dhe deri në vitin 2013 synohet shtrirja e këtij shërbimi edhe në njesitë e tjera vendore. Nga faza e pilotimit rezultojnë se janë vendosur në familje kujdestare 85 fëmijë, në Shkodër 22 fëmijë dhe në Tiranë 63 fëmijë.

Shërbimi i kujdestarisë ofrohet sipas standardeve të miratuar me VKM Nr.752 dt.08.09.2010 "Standardet e Shërbimit të Kujdestarisë për fëmijët në nevojë",

Është miratuar me VKM Nr 89 datë 26.01.2012 "Përcaktimi i kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë. Për vitin 2012 mendohet që numri i fëmijëve që do të përfitojnë këtë shërbim të jetë 150, nga të cilët 80 fëmijë të trajtohen nga projekti UNICEF dhe për fëmijët e tjerë shpenzimet do të përballohen nga buxheti i shtetit.

Fuqizimi i kapaciteteve të stafëve të shërbimeve sociale për fëmijë

Gjatë vitit 2011, SHSSH në bashkëpunim me OSBE-në dhe me Zyrën e Koordinatorit Antitrafikim, kanë zhvilluar 12 trajnime në 12 Bashki dhe Qarqe, me Komitetet Rajonale Antitrafik .

Temat kanë trajtuar çështje të trafikimit të fëmijëve, regjistrimin, funksionet e NJMF, si dhe koordinimin mes aktorëve në nivel lokal.

Në shkurt 2011 Shërbimi Social Shtetëror nënshkroi, marrëveshjen e Bashkëpunimit me Organizatën Terre des Hommes në Shqipëri, në kuadër të projektit "Zhvillimi i Rrjetit të Mbrojtjes për Fëmijët në Shqipëri"(CPSN). Kjo marrëveshje synon të nxisë bashkëpunim dhe të mbështetë iniciativat e Shërbimit Social Shtetëror në punën me institucionet rezidenciale, në bashkitë: Tiranë, Durrës, Sarandë dhe Vlorë,

Përveç trajnimeve, personeli i qendrave do të mbështetet në praktikën e përditshme të punës me fëmijët. Programi do të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë me ndihmë materiale dhe konsulencë teknike për rastet e veçanta të fëmijëve me nevoja të veçanta ose në nevojë për mbrojtje dhe ndihmë specifike.

MBROJTJA NGA DHUNA DHE SHFRYTËZIMI

Regjistrimi

Duke patur parasysh që fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile janë një nga kategoritë më të ekspozuara ndaj abuzimeve apo krimeve të ndryshme, si dhe duke u bazuar në vështirësitë e hasura në praktikë për regjistrimin e tyre në Gjendjen Civile, është miratuar Udhëzimi Nr. 07 Prot, datë 10.01.2012 për *"Miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve që do të plotësohen nga përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të Bashkive/Njërive Bashkiake/Komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në Gjendjen Civile"* dhe janë duke u përgatitur Proçedurat Standarte për *"Regjistrimin e Fëmijëve të Paregjistruar në Gjendjen Civile"*.

Në këtë kontekst deri tani janë evidentuar dhe regjistruar në Gjendjen Civile, 16 fëmijë, të cilët kanë qenë të paregjistruar në gjendjen civile.

Ndonëse me ritme më të ulta ende problemi i fëmijëve të paregjistruar mbetet dhe prek kryesisht fëmijët rom. Sipas studimit të UNICEF dhe Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale "Hartëzimi i fëmijëve rom" nëntor 2011, vlerësohet se janë rreth 359 fëmijë rom të paregjistruar në vend.

Zbatimi i programit Kombi : "Për një shkollë miqësore pro sjelljeve positive"

Në zbatim të të drejtës së fëmijëve për mbrojtje nga dhuna dhe abuzimi, MASH po zbaton Programin Kombëtar Kombi "Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive".

Për njohjen dhe sensibilizimin e strukturave arsimore në nivel DAR/ZA, shkollë dhe kopshti, janë zhvilluar 66 seanca orientimi rajonale në të gjitha DAR të vendit, janë trajnuar 2645 drejtorë dhe nëndrejtorë shkollash, mësues, psikologë, staf nga DAR/ZA. Të gjitha shkollat e vendit janë pajisur me materiale informuese në lidhje me MRD (mënyrat e reja të disiplinimit).

Në të gjitha kopshtet dhe shkollat e arsimit parauniversitar është ngritur këndi i programit Kombi me materiale informuese për MRD. Pjesë e rëndësishme e këtij programi është dhe përfshirja e komunitetit të prindërve në pranimin e MRD.

Në MASH kanë ardhur miratimet e prindërve të nxënësve të të gjitha shkollave të vendit që shprehin mbështetjen dhe miratimin e tyre për zbatimin e këtij Programi.

Shërbimi psikologjik në shkolla

Shtrirja e Shërbimit psikologjik shkollor është një proces i vazhdueshëm që lidhet me plotësimin e standardeve për funksionimin në shkollë. DAR/ZA po bëjnë përpjekje që të sigurojnë kuadrin e psikologëve me arsim përkatës, sigurimin e kushteve të punës siç përcaktohet në Udhëzimin e MASH "Për funksionimin e Shërbimit Psikologjik shkollor".

Aktualisht ky shërbim funksionon në të gjithë zonën urbane të vendit dhe hap pas hapi po shtrihet dhe në zonën rurale, fillimisht në shkolla me numër të lartë të nxënësve.

Ngritja e kapaciteteve me psikologët shkollorë, drejtuesit e shkollave, stafin pedagogjik, fëmijët dhe prindërit duke përdorur përjasje me në qendër fëmijën, promovimin e pjesëmarrjes dhe forcimin e lidhjeve mes shkollës, familjes dhe fëmijës kanë ndikuar në nxitjen e mëtejshme të

shkollave për të përdorur politikat për mbrojtjen e fëmijëve, identifikimin e dhunës brenda dhe jashtë shkollës dhe adresimin e saj përmes përfaqseve multidisiplinare.

Fondacioni Terre des hommes dhe DAR respektivë janë fokusuar në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të psikologëve shkollorë, drejtuesve të shkollave si dhe nxitjen e iniciativave brenda shkollës në drejtim të promovimit të mbrojtjes së fëmijëve. Janë organizuar trajnime me tema: “Këshillimi individual dhe në grup i fëmijëve në shkollë; teknika”- ku janë trajnuar 95 psikologë shkollorë, “ Abuzimi fizik dhe seksual i fëmijëve; identifikimi dhe adresimi”, ku janë trajnuar 102 psikologë shkollorë si dhe është ofruar edhe një trajnim për drejtorët e shkollës “Komunikimi mes aktorëve lokalë në shkollë; nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bordit të shkollës për një mjedës miqësor dhe të sigurt për të mbrojtur fëmijët në mjedisin shkollor”, ku morën pjesë 132 drejtorë shkollash.

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik.

Me miratimin e VKM Nr 265, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij” është qartësuar mënyra se si do të veprojnë praktikisht në terren NJMF, kur një fëmijë ka nevojë të mbrohet.

VKM përcakton personat përgjegjës të grupit teknik multidisiplinar, të cilët ftohen të marrin pjesë në tryezën e diskutimit, sipas nevojave që paraqet rasti.

Aktualisht sot numërohen rreth 49 njësi për mbrojtjen e fëmijëve (shih Aneksin 1) nga 18 që ishin në fillim të vitit 2011.

Një numër i madh i NJMF janë mbështetur nga donatorë të ndryshëm, por në njësitë e reja të ngritura kryesisht gjatë vitit 2012 vihet re një angazhim i kryetarëve të njësive vendore për ngritjen e këtij shërbimi.

Tabela e mëposhtme paraqet shifra për fëmijët e trajtuar nga 16 NJMF për periudhën 2011-2012.

NJËSITE E MBROJTJES SE FEMIJEVE	Fëmijë të trajtuar	Raste të reja	Raste të mbyllura
Bashkia Elbasan	219	56	22
Bashkia Fier	60	0	8
Bashkia Bajram Curri	74	4	8
Bashkia Shkodër	42	0	30
Bashkia Pogradec	64	39	26
Bashkia Kucovë	19	0	1
Njësia Nr 4, Bashkia Tiranë	45	13	3
Bashkia Berat	112	4	0
Bashkia Vlorë	95	0	2
Bashkia Peshkopi	15	5	10
Bashkia Gjirokastër	93	25	25
Bashkia Kukës	65	2	2
Komuna Paper, Qarku Elbasan	3	0	2

Komuna Balldren, Qarku Lezhë	5	0	0
Komuna Dërmenas, Qarku Fier	31	4	2
Komuna Shushicë, Qarku Elbasan	11	0	0
Total	953	152	141

Shifrat tregojnë për një total prej 953 fëmijë të trajtuar gjithësej. Sipas problematikave janë trajtuar fëmijë në gjendje të vështirë ekonomike, të abuzuar, fëmijë që nuk ndjekin apo kanë braktisur shkollën, fëmijë që punojnë apo lypin në rrugë, të braktisur nga prindërit, fëmijë të paregjistruar etj. Nga këta fëmijë 152 raste, kanë qënë raste të reja të identifikuar në periudhën 2011-2012. 142 raste të fëmijëve të tjerë raportohen se janë ndjekur derisa fëmija nuk ka qenë më “në rrezik”.

Gjatë vitit 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka nënshkruar dy Marrëveshje bashkëpunimi që kanë fokus fëmijët:

- Marrëveshje Bashkëpunimi për "Regjistrimin dhe publikimin në faqen zyrtare të internetit (ëeb'it) të "Rrjetit Global të Fëmijëve të Humbur" (GMCN) shkëmbimin e informacionit të ndërsjelltë për gjetjen dhe rikthimin e fëmijëve të humbur, prindërve ose kujdestarëve ligjorë", ndërmjet Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit dhe Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA).
- Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Organizatën Save the Children, për "Mbështetjen, trajtimin, dhënien e ndihmës psiko-sociale, referimin dhe ri-integrimin e fëmijëve nën moshën 14 vjeç; në konflikt me ligjin ". Kjo marrëveshje ka si objekt vendosjen e një bashkëpunimi efektiv të ndërsjelltë për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët nën 14 vjeç, të cilët janë në konflikt me ligjin dhe implementimin e një projekti pilot për Qarkun Tiranë për referimin, mbrojtjen, dhënien e asistencës psiko-sociale dhe ri-integrimin në familje, shoqëri, shkollë të fëmijëve nën 14 vjeç, në konflikt me ligjin.

Punësimi i fëmijëve

Për fëmijët e evidentuar në inspektimet e kryera gjatë vitit 2011, në bazë të të dhënave të ISHP-së për vitin 2011 rezulton se janë të punësuar në total 280 fëmijë.

Respektivisht, mosha e tyre korrespondon:

Mosha	Fëmijë	Përqindje
16 vjeç	71	25%
17 vjeç	166	60%
18 vjeç	43	15%

Burimi: Sektori i Monitorimit dhe Statistikës, MPCSSH

Aktiviteti ku janë përqëndruar më shumë këta fëmijë janë ndërmarrjet prodhuese.

Aktivitetet	
Ndërmarrje	Numri
Ndërmarrje prodhuese (prej tyre)	195
-Përpunim peshku	77
-Prodhim këpucësh	62
-Konfeksione	56
Ndërtim	2
Tregti me shumicë pakicë H-B-R	20
Aktivitete të tjera	60
Transport, telekomunikacion	4

Burimi: Sektori i Monitorimit dhe Statistikës, MPÇSSHB

Vihet re një rritje në numrin e meshkujve, pasi në vitet e tjera rezultonte një përqindje e lartë e vajzave të punësuara në sektorët prodhues të industrisë

Fëmijet sipas grupmoshave		
Mosha	Fëmijë	Përqindje
Arsim	17	6%
Arsim 9-vjeçar	240	85.7%
Arsim imesëm	23	8.3%
Gjinia	Numri	Përqindje
Meshkuj	177	63%
Femra	103	34%

Burimi: Sektori i Monitorimit dhe Statistikës, MPÇSSHB

Së shpejti pritet të miratohen ndryshimet e parashikuara në legjislacionin e punës, VKM-të, në zbatim të Ligjit "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" nr.10237, datë 18.02.2010, ku në nene të veçanta janë parashikuar masat që duhet të marrë punëdhënësi, në konsultim me mjekun e ndërmarrjes për t'i siguruarve punëmarrësve fëmijë një ndjekje mjekësore të veçantë dhe kryerjen e analizave mjekësore dy herë në vit. Këto akte nënligjore janë në proces miratimi në Këshill të Ministrave.

Gjithashtu është në proces rishikimi i Kodit të Punës, ku ndryshimet e propozuara, mendohet se mund të prekin nenin 98 "Mosha minimale" dhe nenin 99 për punën e lehtë, maksimumin e orëve të punës dhe kushtet e punës për fëmijët.

ANEKS I

Njesitë per Mbrojtjen e Femijeve

1. Bashkia Durres
2. Bashkia Fier
3. Bashkia Vlore
4. Bashkia Berat
5. Bashkia Kuçove
6. Bashkia Gjirokaster
7. Bashkia Sarande
8. Bashkia Elbasan
9. Bashkia Pogradec
10. Bashkia Korce
11. Bashkia Shkoder
12. Bashkia Peshkopi
13. Bashkia Kukes
14. Njesia Bashkiake Nr. 4, Tirane
15. Bashkia Bajram Curri
16. Bashkia Lushnje
17. Bashkia Cerrik
18. Njesia Bashkiake Nr. 9, Tirane
19. Bashkia Krume, Qarku Kukes
20. Bashkia, Ballsh, Qarku Fier
21. Bashkia Roskovec, Qarku Fier
22. Bashkia Corovode, Qarku Berat
23. Bashkia Ura Vajgurore, Qarku Berat
24. Komuna Tomin, Diber
25. Komuna Zejmen, Lezhe
26. Komuna Balldre, Lezhe
27. Komuna Novosele, Vlore
28. Komuna Dermenas, Fier
29. Komuna Qender, Vlore
30. Komuna Shirgjan, Elbasan
31. Komuna Gjinar, Elbasan
32. Komuna Paperr, Elbasan
33. Komuna Shushica, Elbasan
34. Komuna Qender, Librazhd
35. Komuna Qukes, Librazhd
36. Komuna Mollaj, Dovran, Korce
37. Komuna Bicaj, Qarku Kukes
38. Komuna Fierze, Qarku Kukes
39. Komuna Topojan, Qarku Kukes
40. Komuna Fajza, Qarku Kukes
41. Komuna Curroj, Qarku Kukes
42. Komuna Greshice, Qarku Fier
43. Komuna Ruzhdie, Qarku Fier

44. Komuna Hekal, Qarku Fier
45. Komuna Velabisht, Qarku Berat
46. Komuna Poshnje, Qarku Berat
47. Komuna Qender, Qarku Berat
48. Komuna Sinje, Qarku Berat
49. Komuna Poton, Qarku Berat